

NJOFTIM

Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 25.05 – 31.07.2020, gjithsej **200 kandidatë**, sipas rajoneve: Tiranë 104, Shkodër 27, Lezhë 2, Durrës 13, Vlorë 2, Berat 28, Elbasan 5, Burrel 1, Kukës 1, Gramsh 5, Poliçan 12 dhe sipas specialiteteve: Ndërlidhje 6, Polici Ushtarake 10, Këmbësori 61, MZ 2, Shofer 37, Mirëmbajtje 9, Kuzhinier 1, Motorist 1, Xhenio 2, Infermieri 11, Roje 58, Muzikant 2.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri në **17 prill 2020**.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
- Të mos jetë në ndjekje penale;
- Të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata;
- Të ketë figurë të pastër morale;
- Të mos ketë probleme me deportimin;
- Të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin;
- Të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale;
- Moshë minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtarë/detarë aktiv nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përgjatë bërësve të vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç;
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar apo të lartë brenda ose jashtë vendit;
- Të kenë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat;
- Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit;
- Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtarë/detarë aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak;
- Të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

2. Procedura e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv.

- a) Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtarë/detarë aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit.
- b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit, pranimit dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, kuotat e rekrutimit, specialitetet, rajonet e rekrutimit, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimi e përzgjedhjes, etj.

3. Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në QPR.

3.1 Kandidatët për ushtarë/detarë aktiv. Paraqesin në Qendrën e Personel-Rekrutimit, dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët në fazën e regjistrimit është:

- Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtrohet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtarë/detarë aktiv, si dhe jo më

pak se dy mundësi zgjedhje për njësinë apo repartin në të cilin do të dëshironte për të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, (formulari i aplikimit);

- Fotokopjen e kartës së identitetit;
- Certifikatë familjare, 1 copë, e cila gjenerohet online nga QPR-ja në bashkëpunim me DMBNJ&SH, në portalin e-albania, sipas akteve ligjore në fuqi;
- Dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm;
- Fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar të noterizuar dhe certifikatën e maturës shtetërore të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore rajonale/rrethit, e noterizuar ose të arsimit të lartë të noterizuar;
- Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), për drejtim automjeti, për njohje të gjuhës angleze, të noterizuara;
- Raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes në qendrën shëndetësore të vendbanimit, ku deklarohet se kandidati është i aftë për punë;
- Ekzaminimet mjekësor për agjentët infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publike në rrethet ku banojnë;
- Në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit, kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv, si dhe formularët e vetëdeklarimit.

b) Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit:

Nëse kandidati shpallet fitues, brenda 2(dy) javëve duhet të sjellë në QPR edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Vërtetim nga gjykata;
- Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko – Ligjor (KML) në Njësinë Mjekësore Ushtarake.

3.2 Qendra e Personel Rekrutimit, në bashkëpunim me strukturat që kanë akses në portalin e-albania, të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarkohet online nëpërmjet portalit qeveritar “e-albania”, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar vetëm në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarkohet nëpërmjet portalit.

3.3 Qendra e Personel-Rekrutimit vijon procedurat e testimit dhe përzgjedhjes vetëm me kandidatët të cilët kanë paraqitur dokumentacionin sipas germës “a”, të pikës 3.1.

Të dhënat tabelore të Testimit të Aftësive Fizike:(Aneksi A)

Meshkuj		Femra		Meshkuj		Femra		Meshkuj		Femra	
Pompa	Pikët	Pompa	Pikët	Palosje/ Shpalosje	Pikët	Palosje/ Shpalosje	Pikët	Vrapim 1000 m	Pikët	Vrapim 1000 m	Pikët
58	100	33	100	71	100	65	100	4'05"	100	4'20"	100
57	99	32	98	70	99	64	99	4'06"	99	4'21"	99
56	98	31	96	69	98	63	98	4'07"	98	4'22"	98
55	97	30	94	68	97	62	97	4'08"	97	4'23"	97

54	96	29	92	67	96	61	96	4'09"	96	4'24"	96
53	95	28	90	66	95	60	95	4'10"	95	4'25"	95
52	94	27	88	65	94	59	94	4'11"	94	4'26"	94
51	93	26	86	64	93	58	93	4'12"	93	4'27"	93
50	92	25	84	63	92	57	92	4'13"	92	4'28"	92
49	91	24	82	62	91	56	91	4'14"	91	4'29"	91
48	90	23	80	61	90	55	90	4'15"	90	4'30"	90
47	89	22	78	60	89	54	89	4'16"	89	4'31"	89
46	88	21	76	59	88	53	88	4'17"	88	4'32"	88
45	87	20	74	58	87	52	87	4'18"	87	4'33"	87
44	86	19	72	57	86	51	86	4'19"	86	4'34"	86
43	85	18	70	56	85	50	85	4'20"	85	4'35"	85
42	84	17	68	55	84	49	84	4'21"	84	4'36"	84
41	83	16	66	54	83	48	83	4'22"	83	4'37"	83
40	82	15	64	53	82	47	82	4'23"	82	4'38"	82
39	81	14	62	52	81	46	81	4'24"	81	4'39"	81
38	80	13	60	51	80	45	80	4'25"	80	4'40"	80
37	79			50	79	44	79	4'26"	79	4'41"	79
36	78			49	78	43	78	4'27"	78	4'42"	78
35	77			48	77	42	77	4'28"	77	4'43"	77
34	76			47	76	41	76	4'29"	76	4'44"	76
33	75			46	75	40	75	4'30"	75	4'45"	75
32	74			45	74	39	74	4'31"	74	4'46"	74
31	73			44	73	38	73	4'32"	73	4'47"	73
30	72			43	72	37	72	4'33"	72	4'48"	72
29	71			42	71	36	71	4'34"	71	4'49"	71
28	70			41	70	35	70	4'35"	70	4'50"	70
27	69			40	69	34	69	4'36"	69	4'51"	69
26	68			39	68	33	68	4'37"	68	4'52"	68
25	67			38	67	32	67	4'38"	67	4'53"	67
24	66			37	66	31	66	4'39"	66	4'54"	66
23	65			36	65	30	65	4'40"	65	4'55"	65
22	64			35	64	29	64	4'41"	64	4'56"	64
21	63			34	63	28	63	4'42"	63	4'57"	63
20	62			33	62	27	62	4'43"	62	4'58"	62
19	61			32	61	26	61	4'44"	61	4'59"	61
18	60			31	60	25	60	4'45"	60	5'00"	60